

VENDIM
Nr. 656, datë 21.9.2016

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 207, DATË 16.3.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NGARKIMIN E OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE SHA) SI ORGAN QENDROR BLERËS, PËR
KRYERJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT PUBLIK PËR LLOGARI TË VET DHE
TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3, të vendimit nr. 207, datë 16.3.2016, të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 3.1 dhe 3.2, me këtë përmbajtje:

“3.1. Ministria e Punëve të Brendshme, pas njoftimit të OSHEE sh.a., për nënshkrimin e kontratës, bën transferimin e fondit në vlerën 400 000 000 (katërqind milionë) lekë, përkatësisht 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga zëri “Investime” dhe 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga zëri “Mallra dhe shërbime”, parashikuar në programin e Gjendjes Civile për projektin “Ndërtimi i një sistemi funksional adresash”, tek OSHEE sh.a.

3.2. Për shërbimet, për të cilat përfituese është Ministria e Punëve të Brendshme (DPGJC), OSHEE sh.a., kryen pagesën pas konfirmimit të marrjes në dorëzim të këtyre shërbimeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama